



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Adresa: Rruga ëAbdi Toptanië, nr. 1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; web-site: klsh.org.al

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 20/12/2018

**V E N D I M**

**Nr. 221, Datë 20/12/2018**

**PËR**  
**AUDITIMIN TEMATIK TË USHTRUAR NË**  
**MINISTRINË E SHËNDËTËSISË DHE MBOJTJES SOCIALE ëMBI REFLEKTIMIN**  
**NË KONTABILITET DHE PASQYRA FINANCIARE TË AKTIVITETIT TË**  
**PROGRAMEVE BUXHETORE TË CILAT NË ZBATIM TË VKM-VE PËRKATËSE**  
**KALUAN NË PËRGJEGJËSINË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË SHËNDËTËSISË**  
**DHE MBROJTJES SOCIALEë**  
**për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017.**

Nga auditimi Tematik ëMbi reflektimin në kontabilitet dhe pasqyra financiare të aktivitetit të programeve buxhetore të cilat në zbatim të VKM-ve përkatëse kaluan në përgjegjësinë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Socialeë konstatohet se, në Pasqyrat Financiare të Aparatit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, **nuk është reflektuar aktiviteti i ish-Aparatit të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**, i cili gjatë vitit 2017, në zbatim të VKM-së nr. 508, datë 13.09.2017 dhe Aktit Normativ Nr. 03, datë 06.11.2017 ëPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 130/2016, ëPër buxhetin e vitit 2017, kaloi në përgjegjësinë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Procesi i riorganizimit të ministrive dhe reflektimit në kontabilitet dhe pasqyra financiare i aktivitetit të ish-MMSR është shoqëruar me problematika, duke e lenë aktivitetin dhe pozicionin financiar të këtij subjekti jashtë raportimit financiar publik në fund të vitit 2017 dhe deri në datën e këtij raporti auditimi, si në aspektin e mos nxjerrjes së akteve të përshtatshme ligjore dhe nënligjore për rregullimin e tij si dhe në mos marrjen e masave në kohë për adresimin e problematikave nga strukturat përgjegjëse në përmbushje të përgjegjësiwe funksionale, megjithëse në dijeni të problematikave. E njëjta problematikë në lidhje me ish-MMSR është vërejtur edhe në auditimin e ushtruar në MFE, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 113, datë 08.08.2018, çka tregon për thyerje të qenësishme të sistemeve dhe raportimit financiar në lidhje me aktivitetin e ish-MMSR. Kjo situatë, ende e pa adresuar nga strukturat përgjegjëse, cenon rëndë transparencën dhe llogaridhënien në lidhje me aktivitetin e këtij subjekti, ekspozon financat publike dhe aktivitetin subjekteve që kanë në përgjegjësi programet e ish-MMSR ndaj risqeve të qenësishme për funksionimin normal të tyre dhe si rrjedhojë kërkon vëmendje të menjëhershme nga Këshilli i Ministrave dhe Komisioni i Ekonomisë dhe Financave.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së

Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të Ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit,

## VENDOSA

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të auditimit Tematik mbi reflektimin në kontabilitet dhe pasqyra financiare të aktivitetit të programeve buxhetore të cilat në zbatim të VKM-ve përkatëse kaluan në përgjegjësinë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sipas Programit të auditimit nr. 1036/1, datë 17.09.2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

### A. OPINIONI I AUDITUESIT:

#### OPINIONI I AUDITIMIT

KLSH ka audituar reflektimet në kontabilitet dhe pasqyra financiare të aktivitetit të programeve buxhetore të cilat në zbatim të VKM-ve përkatëse dhe Aktit Normativ Nr. 03, datë 06.11.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 130/2016, për buxhetin e vitit 2017, kaluan në përgjegjësinë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin ushtrimor përfunduar më 31 dhjetor 2017, e gjendjes ekonomike dhe pozicionit financiar. Objekt i punës tonë ka qenë vetëm auditimi tematik i kontabilitet dhe pasqyra financiare në lidhje me çështjen në fjalë, dhe nuk kemi patur si objekt dhënien e sigurisë në lidhje me tërësinë e informacionit kontabël të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

#### Opinionin e kundërt të KLSH<sup>1</sup>:

Në opinionin tonë, bazuar në procedurat e auditimit të kryera dhe evidencat e mbledhura, aktiviteti i programeve buxhetore të cilat në zbatim të VKM-ve përkatëse kaluan në përgjegjësinë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk është reflektuar në kontabilitet dhe pasqyrat financiare, përfshi mos kryerjen e procesit të transferimit të detyrave dhe të aktivitetit të ish-MMSR nga strukturat përgjegjëse, **çka justifikon dhënien e një opinionin të kundërt nga ana e KLSH.**

#### Baza për opinionin e kundërt

Opinionin e kundërt e bazojmë në konstatimet se:

-Referuar të dhënave të Sistemit Informatik të Qeverisë (SIFQ) dhe Pasqyrave Financiare të dorëzuara nga ish-MMSR për vitin 2016, vlera e aktiveve të Aparatit të ish MMSR-së në mbyllje të aktivitetit të tij, është 1,589,463,658 lekë.

-Referuar lëvizjes së Cash-it në SIFQ, aktiviteti investues 230, 213, të Aparatit të ish MMSR për periudhën janar 2017 deri në momentin kur pushoi së ekzistuari si entitet në fund të nëntorit 2017 është në vlerën 48,769,833 lekë e cila nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare të konsoliduara të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

-Ish MMSR nuk kanë bërë dorëzimin e aktivitetit të institucionit, duke ndikuar në këtë mënyrë në mos realizimin e konsolidimit të Pasqyrave Financiare të Aparatit të MSHMS-së

<sup>1</sup> Manuali i Auditimit Financiar; Opinionin negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi. Formulimi i këtij opinionin qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe është e mundur, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

dhe njëkohësisht në mbartjen e riskut të shtuar në drejtim të miradministrimit dhe ruajtës së aktiveve, duke qenë se mungesa e raportimit sjell edhe mungesën e përcaktimit të përgjegjesisë si dhe konfirmimit të ekzistencës fizike të tyre.

KLSH ka kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin ÷Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë të këtij opinionit. KLSH është e pavarur nga institucionet subjekt auditimi, e theksuar kjo në ISSAI 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike respektive të auditimit të përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH, dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

### **Përgjegjësitë e Drejtimit**

Drejtimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe drejtimi i ish-Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Ligjit ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare, ruajtjen e dokumentacionit mbështetës dhe raportimin e saktë të përdorimit të tyre në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin e MSHMS-së si dhe drejtimi i ish-MMSR janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për nxjerrjen e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë procesin e raportimit financiar.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH**

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e çështjes nën auditim, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Në zbatim të ISSAI-ve, siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar.

Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Procesi i punës audituese e KLSH-së kalon në këto etapa: Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuar, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve.

Krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale, por jo duke patur si qëllim kryesor dhënien e një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njëjësive publike. Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutinë të raportimit të treguesve fiskalë janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se

ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

Komunikojmë me drejtuesin/drejtimin edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Gjithashtu, u mundësojmë drejtuesve një deklaratë ne lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

Identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## B. MASAT ORGANIZATIVE.

**1. Gjetje nga auditimi:** KLSH konstatoi se, në Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale **nuk është reflektuar** aktivitetit i ish Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, pasi:

**a. Baza ligjore është e pa plotë dhe nuk përmbush në kohë realizimin e këtij ristrukturimi, ndërkohë MSHMS nuk e ka ngritur si shqetësim këtë fakt dhe nuk ka iniciuar asnjë procedurë për plotësimin e bazës ligjore për realizimin e këtij procesi:**

1.Me VKM-në nr.508, datë 13.09.2017 òMbi përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u miratua misioni dhe fusha e përgjegjësisë e MSHMS si dhe u shfuqizua VKM 940, datë 09.10.2013 òPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe VKM-ja nr. 845, datë 27.09.2013 òPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;

2.Me shkresën nr. 12615, datë 15.09.2017 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, me subjekt òMbi zbatimin e buxhetit të vitit 2017, pas ndryshimit të Qeverisë në pikën 1, citohet òMinistritë e linjës, entiteti në SIFQ i të cilave nën Qeverinë e re do të pushojë së ekzistuari, si Gr. 25 Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nga datë 14 shtator ndërpresin çdo veprim për zbatimin e buxhetit 2017;

3.Me shkresën nr. 12885, datë 21.09.2017 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, me subjekt òAutorizim mbi zbatimin e buxhetit të vitit 2017, sipas programeve, në pikën 3 citohet: òAutorizohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Gr. 13), për përdorimin e fondeve buxhetore të programeve Planifikim, Menaxhim dhe Administrim; Përkujdesi Social; Përfshirja Sociale dhe Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë. Pra për periudhën 14.09.2017, deri me hyrjen në fuqi të Aktit Normativ nr. 3, datë 06.11.2017, të gjitha pagesat e ish MMSR, janë kryer në SIFQ, nga llogaria e ish MMSR-së (Gr.25), por të sigluara nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i MSHMS (Gr.1).

4.Me shkresa të datës 09.10.2017 të Departamentit të Administratës Publike, janë liruar nga detyra Sekretar i Përgjithshëm i MSH dhe MMSR, duke i kaluar në Listën e anëtarëve të TND-së në pritje dhe është emëruar Sekretar i Përgjithshëm i MSHMS.

5.Me Aktit Normativ nr.3, datë 06.11.2017 nën administrimin e MSHMS, apo njësisive të saj të varësisë, kanë kaluar programet buxhetore si më poshtë:

Planifikim, Menaxhim dhe Administrim (01110), nga grupi 25;

Përkujdesi Social (10430), nga grupi 25;

Përfshirja Sociale (10460), nga grupi 25;

Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik (01190), nga grupi 25.

6.Në VKM nr.717, datë 01.12.2017 òPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në pikën 2 citohet: *òTë gjitha aktivet e qëndrueshme dhe aktivet qarkullueses, që janë në inventarin e personelit të ish Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë që bëhet pjesë e strukturës aktuale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i kalojnë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*

7.Nuk ka asnjë udhëzim apo urdhër tjetër për mënyrën si do të ndahen të drejtat dhe detyrimet për programe të përbashkëta si òPlanifikim menaxhim administrimiò.

**b. Ish-Nëpunësi Autorizues i ish MMSR-së Znj. L. S. dhe ish-Nëpunësi Zbatues i ish MMSR-së, Znj. E. E,** në rolin e nëpunësve të lartë të menaxhimit të njësisë publike, përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, kontabilitetin dhe raportimin financiar, **nuk kanë bërë dorëzimin e detyrës,** në kundërshtim me VKM nr. 124, datë 17.02.2016 òPër pezullimin dhe lirim nga shërbimi civilò, kreu III, neni 27, 28, 29 dhe 30 i tij si dhe udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, duke ndikuar në cilësinë e procesit të përthithjes sipas kërkesave të VKM-së nr.508, datë 13.09.2017 òMbi përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Socialeò. Ky fakt ka sjellë mungesën e dokumentacionit kontabël, dosjeve fizike dhe pamundësi në administrimin e kujdesshëm të aktiveve dhe pasive në pasqyrat respektive të institucioneve që përthithën programe të këtij institucioni, si dhe ka krijuar pamundësi në konfirmimin e ekzistencës reale jo vetëm të aktiveve të qëndrueshme por edhe të të drejtave dhe detyrimeve të rezultuara gjatë aktivitetit të kësaj Ministrie. Aktualisht znj. Znj. L. S. është aktualisht në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror pranë MSHMS-së dhe Znj. E. E. është në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit, Sektori i Bashkëpunimit Marrëveshjeve dhe Kontratave, Drejtoria e Integritit, Kordinimit Marrëveshjeve dhe Asistencës, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatorë dhe Përputhshmërinë pranë MSHMS.

**c. Me urdhrin nr.543, datë 04.12.2017 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese të ish-Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë,** nga ku afati i kryerjes së procesit sipas urdhrit shtrihet në datat 04.12.2017- 08.12.2017 dhe në përfundim të procesit të inventarizimit komisioni inventarizimit duhet të hartojë dokumentacionin përkatës si dhe raportin lidhur me inventarizimin e aktiveve.

Në relacionin e hartuar nga komisioni citohet: òKomisioni **nuk ka bërë krahasim me inventarët kontabël,** pasi periudha që kanë pasur fletët e inventarit në dispozicion (viti 2015), ka pasur lëvizje në organizimin e zyraveò. Konstatohet se në përbërje të komisionit kanë qenë edhe ish Nëpunësja Zbatuese e MMSR-së, e cila referuar udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar i duhet ti paraqesë komisionit të inventarizimit listën e asetëve sipas të dhënave të kontabilitetit. Mosparaqitja e këtij dokumentacionit ka krijuar kushtet për mos evidentimin e vlerës reale të asetëve të përthithura nga ana e ish-MMSR dhe mos pasqyrimin e tyre në kontabilitet. Duhet të theksojmë se në vitin 2017, MMSR ka pasur lëvizje të shpeshta të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, si dhe një rokadë lëvizjesh midis strukturave të MMSR dhe MSHMS.

Sipas të dhënave në SIFQ, vetëm aktiviteti investues i MMSR-së (230&231) si aparat, për periudhën Janar 2017 deri në momentin kur pushoi së ekzistuari si entitet në fund të nëntorit 2017, është në vlerën **48,769,833 lekë,** vlerë që nuk është pasqyruar në Pasqyrat Financiare të MSHMS-së për vitin 2017. **Në lidhje me të drejtat dhe detyrimet,** që i takojnë programeve të përthithura nga MSHMS nuk ka asnjë veprim për konsolidimin e tyre në pasqyrat financiare të Aparatit të MSHMS, duke sjellë minimalisht riskun e rritjes së detyrimeve të prapambetura dhe mos ndjekjes së procedurave ligjore për realizimin e të drejtave të shtetit.

**d. Nga ana e Nëpunësit Autorizues të MSHMS-së,** si përgjegjës për planifikimin, menaxhimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar të veprimtarisë së institucionit, megjithëse referuar dokumentacionit të sjellë nga ana e tij, ka qenë njoftuar nga Nëpunësi Zbatues në lidhje me situatën e krijuar, **nuk janë marrë masat e nevojshme** për marrjen në ngarkim të të gjithë

elementëve pasurorë dhe jo pasurorë të aparatit të ish MMSR-së. Nga ana tjetër Nëpunësi Zbatues nuk e ka theksuar këtë fakt në relacionin shpjegues që shoqërojnë pasqyrat financiare të aparatit të MSHMS-së. Pasqyrat Financiare nuk janë të firmosur dhe miratuar nga Nëpunësi i Autorizues i Aparatit të MSHMS, në kundërshtim me nenin 42 të Ligjit 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Pasqyrat financiare janë firmosur nga Shefi Financës në cilësinë e Haruesit dhe Nëpunësi Zbatues në cilësinë e Drejtuesit të Aparatit të MSHMS. Në relacionin shpjegues, të Pasqyrave Financiare, nuk ka asnjë shpjegim që në këto pasqyra, nuk është përfshirë aktiviteti 11 mujor i ish Aparatit të MMSR-së. Në shkresën nr.5484, datë 26.12.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS me subjekt òMbi përgatitjen dhe depozitimimin e Llogarive Vjetore të Vitit 2017ò citohet: *òLlogaritë vjetore duhen detyrimisht të jenë të shoqëruara nga hartuesi i tyre për të dhënë shpjegimet përkatëse pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. Në rast të kundërt, llogaria vjetore e vitit 2017, do të konsiderohet jo e rregulltò. Pra, duke qenë në dijeni të problematikave të trajtuara më lart, Nëpunësi Autorizues i MSHMS pranon se këto Pasqyra Financiare nuk janë të rregullta.*

### **1.1 Rekomandimi:**

**a.** Strukturat Drejtuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë/ Nëpunësi i Parë Autorizues, Strukturat Drejtuese të MSHMS/Nëpunësi Autorizues i saj dhe Strukturat Drejtuese të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit/ Nëpunësi Autorizues i saj, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik, të realizojë procesin e ndarjes, konsolidimit të elementëve të pasqyrave financiare të ish Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, sipas VKM nr.508, datë 13.09.2017 òMbi përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas ndryshimit të fushës së përgjegjësisë, si dhe të përcaktohen përgjegjësitë individuale dhe funksionale për mos realizimin e këtij procesi në përputhje me bazën ligjore. Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në përfundim të këtij procesi, të merren masa për përfundimin e procesit të konsolidimit të gjithë elementëve të pozicionit financiar që i takojnë pas përthithjes së programeve të përthithura nga Ministria e Mirëqenies Sociale.

**b.** Strukturat Drejtuese të MSHMS/Nëpunësi Autorizues i MSHMS-së, të marrë masat e nevojshme për të përfunduar procesin e dorëzimit të detyrës nga ish punonjësit e MMSR-së, veçanërisht për punonjësit të cilët kanë pasur në ngarkim aktivitetet e institucionit, brenda një afati të caktuar prej tij të bëjnë të mundur dorëzimin i tyre. Për çdo mungesë apo dëmtim të aktiveve në ngarkim të personave përgjegjës për mbajtjen e tyre të merren masa e nevojshme kundrejt legjislacionit në fuqi.

**c.** Pasqyrat Financiare të Aparatit të MSHMS dhe njëkohësisht Pasqyrat e Konsoliduara të MSHMS të vitit 2017, duhet të miratohen nga Nëpunësi Autorizues i MSHMS, në cilësinë e Drejtuesit të institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi **miratimin e strukturës së re organike** dhe marrjes në ngarkim të detyrave, pas procesit të përthithjes së veprimtarisë të programeve buxhetore, rezultoi se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka reflektuar asnjë prej vendimeve gjyqësore të strukturave dhe programeve të përthithura nga ish-MMSR. Si rezultat, nuk mund të shprehemi për detyrimet e mundshme si pasojë e mosvënies në dispozicion të kësaj evidence auditimi, duke evidentuar një risk të lartë në vlerësimin e detyrimeve ligjore si Institucion përgjegjës për mbajtjen dhe reflektimin e tyre në bilancin vjetor të njësisë. Grupit të auditimit iu vu në dispozicion vetëm lista e vendimeve gjyqësore me objekt rikthimin në punë për të larguarit nga puna të Ministrisë së Shëndetësisë.

**2.1 Rekomandimi:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për përfundimin e përthithjes së vendimeve gjyqësore të ish-MMSR, në mënyrë që të shmangen

impaktet e padëshiruara në lidhje me krijimin e detyrimeve të prapambetura si pasojë e mosparaqitjes në kohë të vendimeve për shlyerjen e tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **C. MASA DISIPLINORE**

### **C.1: MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE;**

### **C.2: SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË:**

**a.** Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*, në zbatim të nenit 58, *“Llojet e masave disiplinore të ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2017 “Për nëpunësin civil, i ndryshuar me Ligjin nr.178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendim-marrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, i rekomandojmë Titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Nëpunësit Autorizues, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara për dhënien e masave disiplinore si më poshtë vijon:*

*Nga “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshi rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjetë deri në “Largim nga shërbimi civil për:*

1- L. S. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror.

2- E. E. me detyrë Përgjegjës Sektori, sektori i Bashkëpunimit Marrëveshjeve dhe Kontratave, Drejtoria e Integritit, Koordinimit Marrëveshjeve dhe Asistencës, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatorë dhe Përputhshmërinë

Për përgjegjësitë si Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësin Zbatues të ish MMSR-së që aktualisht janë pjesë e stafit të MSHMS-së, në lidhje me mos dorëzimin e detyrës.

*Nga “Mbajtja deri në një të tretën e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muajë deri në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshi rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjetë për:*

1. A. K. me detyrë Nëpunës Autorizues i MSHMS.

2. S.K. me detyrë Nëpunës Zbatues i MSHMS

Për mosmarrjen e masave në kohë për adresimin e problematikave dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të paplota.

**b.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil, i ndryshuar.*

**c.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil, i ndryshuar*

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **D. TË TJERA.**

**1.** Referuar problematikave të konstatuara me ish-MMSR-në të cilat vijnë ende dhe që përbëjnë një precedent të rëndë, KLSH i rekomandon Kryeministrit dhe Këshillit të Ministrave, ndjekjen dhe mbikëqyrjen me prioritet të procesit të 1. Identifikimit dhe marrjes së masave disiplinore për funksionarët publik përgjegjës për këtë proces në të gjitha nivelet, 2. Zbatimin e masave që do të ndërmerren nga Ministrinë në lidhje me reflektimin, dokumentimin dhe

raportimin e aktivitetit të ish-MMSR në pasqyrat financiare të shtetit dhe 3. Garantimit që i gjithë informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me aktivitetin e ish-MMSR të jetë nën administrim dhe marrë në dorëzim nga ministritë ekzistuese sipas fushave të përgjegjësisë.

**2. Raporti dhe Vendimi përcillen për dijeni Komisionit për Ekonominë dhe Financat.**

*Ky Raport dhe Vendimi i Kryetarit të KLSH-së, të përcillet si indicie penale në prokurori nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit dhe Departamenti Juridik.*

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**